



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 362 , datë 29.4.2011

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE
TË TRANSFERIMIT, MËNYRËS SË APLIKIMIT PËR SHTYRJEN
E AFATEVE DHE SHNDËRRIMIT TË LEJEVE MINERARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 41, pika 5, e 56, pika 1, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejet minerare të kërkim - zbulimit, shfrytëzimit dhe kërkim - zbulim - shfrytëzimit, të dhëna sipas procedurave konkurruese, lejet minerare për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, si dhe lejet minerare, të cilat, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 47, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka filluar veprimtaria minerare, janë të patransferueshme.
2. Personat juridikë, vendas dhe/ose të huaj, të pajisur me leje minerare, në zbatim të dispozitave ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, mund të transferojnë lejen minerare tek persona të tjerë juridikë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
3. Kriteret që duhet të përmbushin aplikuesit për transferimin e një lejeje minerare janë ligjore, financiare, teknike dhe profesionale, të përcaktuara si më poshtë:

A. Ligjore:

- a) të jetë një person juridik, i regjistruar si i tillë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- b) të pranojë, së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet;
- c) të dy subjektet, zotëruesi i lejes minerare dhe përfituesi i saj, duhet të pranojnë se ndërtime dhe instalime të tjera, që mbështesin operacionet kryesore të veprimtarisë minerare, vlerësohen veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të.

B. Financiare:

Të ketë aftësi financiare për vazhdimin e realizimit të investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare.

C. Teknike dhe profesionale:

Të ketë aftësi teknike dhe profesionale për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare dhe projektin e rehabilitimit të mjedisit.

4. Dokumentet vërtetuese për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të transferimit, që duhet të plotësojnë aplikuesit për transferimin e një lejeje minerare, janë këto:

- a) Kërkesa, te ministri, për transferimin e lejes minerare, nga zotëruesi i lejes minerare, ku të jetë përshkruar arsyeja/arsyet e transferimit;
- b) Ekstrakti i vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), për regjistrimin si person juridik, ku, në objektin e veprimtarisë, të jetë i miratuar edhe zhvillimi i veprimtarisë minerare të subjektit që kërkon të marrë lejen minerare;
- c) Një përshkrim i kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të subjektit që kërkon të marrë lejen minerare, të cilat i vlejné atij për realizimin e veprimtarisë minerare dhe asaj të rehabilitimit mjedisor, të përcaktuar në lejen që kërkohet të transferohet, duke përfshirë edhe curriculum vitae të stafit të tij, që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrimi i përvojës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka;
- ç) Konfirmimi për burimet financiare, të nevojshme për realizimin e investimeve të programuara për të zhvilluar veprimtarinë minerare të subjektit që kërkon të marrë lejen minerare, të vërtetuar nga dhe/ose një nga dokumentet për ekzistencën e tyre, si më poshtë:

- i. Një deklaratë nga banka, që konfirmon se personi juridik ka çelur numrin e llogarisë, ku të ketë të depozituar të paktën 20 % të vlerës së investimit të parashikuar në programin e investimeve që ka paraqitur;
 - ii. Një dokument që vërteton se personi juridik ka siguruar një kredi prej një banke, ose subjekti tjetër financiar, me vlerë e cila mbulon investimet që parashikohen të kryhen;
 - iii. Një kontratë me një investitor, i cili garanton mbështetje financiare për realizimin e programit të investimit. Në këtë rast, personi juridik duhet të paraqesë një dokument noterial, në të cilin shprehet vullneti i investitorit për të mbështetur këtë investim, si dhe dokumentet që provojnë burimet financiare të këtij të fundit (garanci bankare ose bilancet ekonomike të shoqërisë, në të cilën investitori është pronar/aksionar i vetëm, ose aksionar i shumicës së zotërimit të aksioneve/kryesor maxhoritar).
- d) Aktmarrëveshja, e nënshkruar përpara noterit, ndërmjet dy shoqërive, për transferimin e lejes minerare, ku të jetë përcaktuar që subjekti, i cili kërkon të marrë lejen minerare, pranon, së bashku me transferimin e lejes minerare, përgjegjësinë për të gjitha detyrimet kundrejt shtetit apo palëve të treta, të cilat rrjedhin nga leja minerare që transferohet, si dhe detyrimet, sipas përcaktimeve të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
 - dh) Vërtetimi nga dega e tatim taksave, që zotëruesi i lejes minerare nuk ka detyrime të pashlyera;
 - e) Vërtetimi nga dega e tatim taksave, që subjekti, i cili kërkon të marrë lejen minerare, nuk ka detyrime të pashlyera;
 - ë) Miratimi për kapacitetet e prodhimit vjetor, vlerën e investimeve, vlerat e garancive, të përcaktuara në nenin 31, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
5. Zotëruesi i lejes minerare paraqet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dokumentacionin e plotë për transferimin e lejes minerare.
 6. Vlerësimi i kushteve të transferimit dhe dokumentet vërtetuese për kërkesat për transferimin e një lejeje minerare realizohen nga drejtoria përkatëse në ministrinë që mbulon veprimtarinë minerare në Republikën e Shqipërisë. Kjo drejtori harton aktin e transferimit të lejes minerare, që miratohet nga ministri.
 7. Ministri, brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit, nxjerr aktin e miratimit ose refuzimit të transferimit të lejes minerare, të cilin e dërgon në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), për të reflektuar ndryshimet përkatëse.

8. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve, si ndryshime të titullit të lejes, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e transferimit është data e regjistrimit në regjistrin Kombëtar të Licencave/Autorizimeve dhe Lejeve. Akti i transferimit depozitohet edhe në regjistrin minerar, sipas strukturave përgjegjëse.
9. Kërkuesi merr dijëni për miratimin ose jo të kërkesës në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, pranë QKL.
10. Subjektet minerare, që aplikojnë për shtyrje afati për lejet e tyre minerare, duhet të paraqesin kërkesën e aplikimit pranë sporteleve të QKL-së.

Kërkesa duhet të përmbajë një informacion të plotë, për realizimin e detyrimeve të lejes së tyre minerare, në përputhje me kushtet e lejes dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi, si dhe arsyet e shtyrjes së afatit të lejes. Strukturat përgjegjëse, sipas tipit të lejes, realizojnë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e kërkesës, vlerësimin e kërkesës për shtyrje afati, duke vlerësuar në mënyrë dokumentare dhe në terren realizimin e detyrimeve nga zotëruesit e lejeve minerare dhe arsyet e shtyrjes së afatit dhe e paraqesin për miratim në ministri.

Ministri, brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit, nxjerr aktin e miratimit ose refuzimit të shtyrjes së afatit të një lejeje minerare, të cilin e dërgon në QKL.

Të gjitha subjekteve, që, në respekt të legjislacionit të ri minerar, kanë aplikuar për zgjatje afati, deri në miratimin e këtij vendimi, u lind e drejta e riaplikimit pranë QKL-së.

11. Aplikimet për shndërrimin e një lejeje minerare kërkim - zbulimi në një leje shfrytëzimi realizohen pranë institucionit të QKL-së.

Dokumentacioni i plotë i aplikimit për një leje minerare shfrytëzimi, nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkim - zbulimit, paraqitet pranë sporteleve të QKL-së. Data e aplikimit të dokumentacionit të plotë është datë e përllogaritjes së afatit për miratimin e heshtur.

Përmbajtja e dokumentacionit të plotë të aplikimit, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tij janë të njëjta me ato kërkesa që aplikojnë subjektet për marrjen e një lejeje minerare në zonat e hapura.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë dhe vlerësimin nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), për realizimin e detyrimeve të lejes së kërkim zbulimit.

Të gjitha subjekteve, që, në respekt të legjislacionit të ri minerar, kanë aplikuar për shndërrimin e lejes së kërkim - zbulimit në një leje shfrytëzimi, deri në miratimin e këtij vendimi, u lind e drejta e riaplikimit pranë QKL-së.

12.Për rastet e parashikuara në pikat 10 dhe 11, të këtij vendimi, për zonën e lejuar minerare, për të cilën kërkohet shtyrje në afat ose shndërrim i tipit të lejes, kërkuesi ka të drejtën ekskluzive për plotësimin e dokumentacionit përkatës për këtë zonë, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

13.Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.


KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS**


NASIP NAÇO



NR.PROT.1386/1
DATË 20.5.2011

MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR
AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE
QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL)
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHA
Sekretar i Përgjithshëm

A circular official stamp is visible behind the signature. The text within the stamp is partially obscured but appears to contain the name of the institution and the date. The signature is written in black ink over the stamp.